



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 34/08

Prishtinë, më 5.12.2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka.

Anëtarët jo të pranishëm: Hajdin Abazi, Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Agim Krasniqi Drejtor i Buxhetit në MEF, Behxhet Haliti nga MEF-i, përfaqësues të organizatave buxhetore të ftuara për në mbledhje, Teki Shala, Shefki Kastrati nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009:
 - 2.1. Shqyrtimi i buxhetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit
 - 2.2. Shqyrtimi i buxhetit të Zyrës së Rregullatorit për Energji
 - 2.3. Shqyrtimi i buxhetit të Zyrës së Auditorit Gjeneral
 - 2.4. Shqyrtimi i buxhetit të Agjencioni Kosovare kundër-Korrupsionit
 - 2.5. Shqyrtimi i buxhetit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale
 - 2.6. Shqyrtimi i buxhetit të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina
 - 2.7. Shqyrtimi i buxhetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-20 për

kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente

4. Të ndryshme.

Kryesuesi, njoftoi se pika e 2.1. dhe 2.7. shtyhen për në mbledhjen e radhës. Më pas hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2.1. Shqyrtimi buxhetit të Zyrës së Auditorit Gjeneral

Kryesuesi, theksoi se në bazë të deklarimeve të mëhershme të zv.ministri të MEF-it të gjitha agjencionet kanë mjete për funksionim për gjashtë muajt e parë të vitit. Pyeti përfaqësuesit ZAGJ-së se a mundet kjo Zyrë të funksionojë me buxhetin e miratuar nga Qeveria.

Niman Zeneli, theksoi se dallimi i buxhetit nga ai i miratuar nga MEF-i qëndron prej 211.000 € më pak. Miratimi i buxhetit siç është propozuar nga MEF-i rrezikon punën e këtij Agjencioni.

Behxhet Haliti, përsëriti qëndrimin e MEF-it se nuk do të ketë probleme në mungesë të buxhetit për kryerjen e punëve të agjencioneve përkatëse, në këtë mënyrën edhe të ZAGJ-së. Arsyeja e zvogëlimit në kategorinë mallra dhe shërbime, është bërë për shkak të politikës qeveritare për kursime në këtë kategori.

Haki Shatri, kërkojë që mos të pengohet puna e agjencionit në mungesë të pagave të mjaftueshme. Ndërsa ndryshimi në mallra dhe shërbime është bërë për shkak të kufizimeve që janë bërë në këtë kategori ekonomike për të gjitha organizatat buxhetore.

Kryesuesi, njoftoi për vendimin e marrë nga Komisioni i cili nuk është përfill, prandaj kërkoi që të plotësohet kërkesa për paga dhe mëditje, ndërsa plotësimi i nevojave për mallra dhe shërbime, të shikohet me rastin e rishikimit të buxhetit.

Agim Krasniqi, theksoi se nuk ka rezerva në buxhet për të bërë plotësime. Çështje e pagave të shikohet me rastin e rishikimit të buxhetit. Rekomandimet e komisionit i kemi marrë me vonesë pas përfundimit të procesit buxhetor. Nuk u pajtua që stafi civil i këtij agjencioni dhe i agjencioneve tjera të pavarura të kenë paga më të mëdha se shërbyesit tjerë civil.

Safete Hadërgjonaj, kërkojë që mos të shkelin ligjin, por të respektohen rregullat ekzistuese për përcaktimin e pagave. Theksoi se jemi pajtuar të bëhet rritja pagave por jo për të gjithë njësoj. Duhet shikuar pozicion për pozicion dhe për të ofruar një zgjidhje në këtë çështje. Nga buxheti i vitit 2009 shifet se janë bërë ngritje pagave për të gjithë punonjësit e këtij agjencioni.

Shkumbin Demaliaj, edhe buxheti është ligj, prandaj të shikohet mundësia e harmonizimeve të mundshme më qëllim të plotësimit të kërkesave të arsyeshme. Të shikohet me kujdes mundësia e ndryshimeve.

Kryesuesi, kërkesa për paga është e arsyeshme. Prandaj qëndrimi i Komisionit duhet të jetë të plotësohen kërkesat për paga dhe mëditje, me mundësinë e lëvizjeve buxhetore brenda kufijve të buxhetit.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohet kërkesa buxhetore e Zyrës së Auditorit Gjeneral në linjën paga dhe mëditje, me mundësinë e plotësimit të kësaj kërkesë nga lëvizjet e mundshme buxhetore brenda kufijve të buxhetit të Kosovës për vitin 2009.

2.2. Shqyrtimi buxhetit të Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit

Kryesuesi, ia dha fjalën përfaqësuesit të agjencionit të arsyetojnë kërkesën e tyre buxhetore.

Hasan Preteni, theksoi se dallimi në mes kërkesës së aprovuar nga MEF-i është 56.381 € të papërfshira në emër të kategorisë paga dhe meditje (mjetet të parapara për shujtë dhe rrezikshmëri).

Safete Hadërgjonaj, theksoi se nuk është e nivelit të njëjtë rrezikshmëri e personave që punojnë në këtë agjencion, prandaj duhet të merret parasysh ky element me rastin e vendosjes për paga të punëtorëve të këtij agjencioni.

Besa Gaxheri, vlerësoi rëndësinë e pavarësisë së agjencionit ndaj Qeverisë, prandaj Komisioni duhet të ndihmojë atë edhe me rastin e krijimit të pavarësisë financiare të tij.

Safete Hadërgjonaj, nuk u pajtua me parafolësen se këto agjencione kontrollohen nga dikush. Theksoi se ato iu nënshtrohen kontrollit nga parlamenti. Problemet në paga janë shfaqur në mungesë të një rregullative të qartë ligjore. Mjetet e parapara për rrezikshmëri duhet të ndahen për ata që janë të rrezikuar dhe jo për të gjithë siç është kërkuar.

Riza Smaka, bëri vërejtje rreth përgatitjes teknike të kërkesës. Pagat duhet përcaktohen duke pasur për bazë kriteret e përgjegjshmërisë, ndërlikshmërisë dhe rrezikshmërisë në punë. Problemet janë shfaqur dhe po shfaqën në mungesë të Ligjit për paga.

Xhevdet Neziraj, duke ditur rëndësinë e funksionimit të agjencionit, kërkoi që me rastin e marrjes vendosje së buxhetit të këtij agjencioni, të shikohet mundësia e pranimit të kësaj kërkesë.

Kosara Nikolic, theksoi se nëse dëshirohet të luftohet korrupsioni duhet përkrahur këtë agjencion, prandaj edhe duhet plotësuar kërkesat reale të tyre që kanë të bëjë me rrezikshmëri. Të analizohet kërkesa për rrezikshmëri dhe të veprohet në kuadër të kufijve të mundshëm buxhetor.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni përkrah kërkesën buxhetore të Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit për vitin 2009, plotësimi i saj do të bëhet nga lëvizjet e mundshme buxhetore brenda kufijve të buxhetit të Kosovës për vitin 2009.

2.3. Shqyrtimi buxhetit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Kryesuesi, ia dha fjalën përfaqësuesit të agjencionit të arsyetojnë kërkesën e tyre të fundit buxhetore.

Ali Hamiti, theksoi se ndryshimet janë bërë si rezultat i kompromiseve me këtë Komision. Janë bërë këto ndryshime, në kategorinë paga dhe mëditje nga shuma 401,045€ në shumën prej 364,998€, mallra dhe shërbime nga shuma 585,500€ në shumën prej 562,000€, shpenzimet komunale nga shuma 17,500€ në shumën prej 12,000€, shpenzimet kapitale nga shuma 131,000€ në shumën prej 47,000€. Nga kategoria paga dhe mëditje janë hequr 36.075 € për shkak të mosrekrutimit të gjashtë punëtorëve të paraparë për vitin 2009.

Safete Hadërgjonaj, duke u ndërlidhur në diskutimet rreth pagave, theksoi se bordi duhet veçuar, por shërbyesit civil të këtij agjencioni duhet të kenë tretman të njëjtë me shërbyesit tjerë civil të organizatave buxhetore. Pyeti a keni ndonjë punëtor me shkollë të mesme. Po ashtu bëri vërejtje për bartjen e mjeteve nga viti kaluar në projektin “shërbime këshillëdhënëse”.

Haki Shatri, lexoi shkresën e Ministrit të MEF-it, kujtoi rekomandimet e FMN-së për paga. Duke i pasur parasysh gjitha këto kërkoj të bëhet harmonizimi në paga.

Ali Hamiti, pagat janë më të ulëta në krahasim me rregullatorët e rajonit. Njerëzit janë aseti kryesorë i këtij rregullatori, prandaj edhe kërkohen paga relevante. Duke iu përgjigjur znj. Hadërgjonaj theksoi se janë vetëm dy punëtor me shkollë të mesme, por megjithatë kryejnë punë me përgjegjësi të lartë. Ndërsa arsyeja e bartjes së mjeteve nga projekti shërbime këshillëdhënëse, ka të bëjë me gjetjen e donacioneve për kryerjen e atyre shërbimeve.

Besa Gaxheri, kërkoi që të përkrahet ky agjencion. Pagat duhet të jenë të krahasueshme me ato të regjionit. Një punëtor i ZRRE-së punon më shumë se sa një Këshilltar i Kryeministrit, prandaj edhe duhet të përcaktohen pagat në bazë të përgjegjësisë që kanë.

Riza Smaka, kritikoi pagat e larta të parashikuara për anëtarët e bordit. Janë paraparë 278.000 € për ekspertë tjerë, ndërsa në anën tjetër kërkoni të keni paga më të larta me arsyetimin se të gjithë jeni ekspert.

Kryesuesi, duke u ndërlidhur në diskutimet, theksoi se rregullatorët nuk mund të kenë paga më ta ulëta se sa tregu që rregullojnë, prandaj edhe punëtorët e këtij agjencioni duhet që të kenë paga të arsyeshme në raport me fushën dhe tregun që rregullojnë .

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni përkrah kërkesën buxhetore të Zyrës së Rregullatorit për Energji me ndryshimet bëra në kategoritë e caktuara ekonomike, të cilat ndryshime Komisioni rekomandon që të pasqyrohen në linjat buxhetore të këtij agjencioni në kuadër të tabelave buxhetore të buxhetit të Kosovës për vitin 2009.

2.4. Shqyrtimi buxhetit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryesuesi, kërkoi sqarime nga sqarime nga përfaqësuesit e këtij agjencioni për kërkesën në fjalë.

Azem Rexhaj, përmendi takimet e zhvilluara me anëtarët e nënkomisionit me qëllim të reduktimit të kërkesë së tyre. Pas takimeve është arritur pajtueshmëri që të bëhen zbritje në kategorinë paga dhe mëditje nga shuma 474,315€ në shumën prej 473.136€ mallra dhe shërbime nga shuma 669,400€ në shumën prej 616.648€ dhe shpenzime kapitale nga shuma 500,000€ në shumën prej 340,000€ si dhe zbritja e numrit të punëtorëve nga 82 në 79.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni përkrah kërkesën buxhetore të Komisionit për Miniera dhe Minerale, me ndryshimet e bëra konform arritjes së marrëveshjes së këtij agjencioni me nënkomisionin për buxhet dhe financa dhe rekomandon që këto ndryshime të pasqyrohen në linjat buxhetore të këtij agjencioni në kuadër të tabelave buxhetore të buxhetit të Kosovës për vitin 2009.

2.5. Shqyrtimi buxhetit të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

Kryesuesi, kërkoi sqarime nga përfaqësuesit e këtij agjencioni për kërkesën në fjalë.

Afrim Lajçi, njoftoi se pas takimit të zhvilluar me anëtarët e nënkomisioni për buxhet dhe financa, kanë bërë këto ndryshime të kërkesës së tyre buxhetore prej 171.431 € Zbritje janë bërë në kategorinë paga dhe mëditje nga shuma 224,250€ në shumën prej 150,256€ mallra dhe shërbime nga shuma 225,200€ në shumën prej 184,300€ dhe shpenzime komunale nga shuma 4,850€ në shumën prej 4,650.

Agim Krasniqi, kërkesa e këtij rregullatori është më afër asaj të miratuar nga MEF-i se sa rregullatorët tjerë

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni përkrah kërkesën buxhetore të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, me ndryshimet e bëra konform arritjes së marrëveshjes së këtij agjencioni me nënkomisionin për buxhet dhe financa dhe rekomandon që këto ndryshime të pasqyrohen në linjat buxhetore të këtij agjencioni në kuadër të tabelave buxhetore të buxhetit të Kosovës për vitin 2009.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-20 për teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, njoftoi se amendamenti i propozua nuk përmban implikime buxhetore, prandaj kërkoi që ta mbështesin raportin e komisionit funksional.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-20 për teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, dhe ka konstatuar se amendamenti nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.

4. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi për sjellje e teksteve të spastruara dhe amendamenteve për tri ligjet e ndryshimeve fiskale nga përfaqësuesit e zyrës ligjore të MEF-it. Kërkoj që të shikohen ato dhe të bëhen rekomandimet në formë të amendamenteve për ato ligje.

Gjithashtu propozoi që për takimin që do të mbahet në Shkup në vend të tij të jetë znj. Safete Hadërgjonaj.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se Agjencioni Rregullativ i Telekomunikacionit (ART-ja) nuk ka sjellur raport për vitin 2007 dhe 2008. Gjithashtu as kërkesën buxhetore për vitin 2009. Kërkoj që të vihen kontaktet me këtë rregullator dhe të kërkohet që të sjellin buxhetin për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi, pranoi vërejtjet e parafolëses. Por theksoi se nuk duhet lënë pa buxhet. Buxheti të miratohet i njëjtë me vitin e kaluar.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI